



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN, TIRANË

Nr. 2369/16 prot

Datë, 03/10 /2019

VENDIM

Nr. 15 Datë 20/09 /2019

PËR

MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR (PUSHPIM), NJËSIA BASHKIAKE NR.3, TIRANË, PËR SUBJEKTIN "ARBEN PUSTINA" person fizik, PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE (LAVAZH)

Në mbështetje të ligjit nr.111/2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" të ndryshuar, neni.41 pika 1 gërma "e", neni.50 pika 2, vendimit nr.416, datë 13.5.2015, "Për miratimin e kushtëve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit nr.221, datë 26.04.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", vendimit nr.6, datë 16.02.2016, për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", neni 11 pika 3 dhe vendimit nr.6, datë 12.06.2019, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor", me propozim të Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Ishëm-Erzen-Mat, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

VENDOSI:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim të burimit ujor nëntokësor (pus-shpim), për subjektin "Arben Pustina" person fizik, për përdorim teknologjik "Lavazh", Njësia Bashkiake nr.3, Bashkia Tiranë, me këto të dhëna:

- Koordinatat e pusit: X 486696.96 Y 4577780.90 Z 138;
- Kapaciteti i pusit 0.000289 m³/s;
- Volumi maksimal i ujit që kërkohet 0.0000671 m³/s;
- Sasia e ujit që do jepet në përdorim 0.0000671 m³/s ;
- Qëllimi i përdorimit Ujë teknologjik (Lavazh);
- Vendi shkarkimit të ujrave të përdorura Rrjeti i kanalizimeve, UK Tiranë.

2. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

